



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 9-32/2020 regjistër (JR)
Datë 09.04.2024

Nr. 64 i vendimit
Datë 24.03.2026

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Natasha Mulaj	Anëtare
Ina Rama	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 24.03.2026, ditën e martë, në orën 14:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Laureta Mehmetaj, çështjen që i përket:

KËRKUESE: Bernina Kondi, lindur më {***}, dhe banuese në adresën: rruga “{***} pallati “{***}”, ap. {***}, Tiranë.

OBJEKTI: Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 37 (JR), datë 11.10.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

BAZA LIGJORE: Neni 6, pika 1 e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut; vendimet e GjEDNj-së për çështjet “Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë”, “Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës”; nenet 42 dhe 44 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 6/2006, nr. 9/2010 dhe 20/2011; nenet 494, 495, 496, 497, 498 dhe 498/a të Kodit të Procedurës Civile; neni 15, pika 1, germa “c” e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.07.2017, të Mbledhjes së Gjyqtarëve, e ndryshuar.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi pretendimet e kërkuesses në kërkesat e paraqitura prej saj, si dhe parashtrimet me shkrim, e cila përfundimisht kërkoi rishikimin e vendimit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 37 (JR), datë 11.10.2022, dëgjoi gjyqtaren relatore të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja Bernina Kondi (në vijim “kërkuesja”), i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, sipas përcaktimeve të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”). Fillimisht kaloi fazën e hetimit dhe shqyrtimit administrativ pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim, “Komisioni”), i cili me vendimin nr. 259, datë 15.06.2020, vendosi: *shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Bernina Kondi, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë. Ky vendim është ankuar nga subjekti i rivlerësimit, pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”).*
2. Pasi ka shqyrtuar ankimin e subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit, me vendimin nr. 37/2022 (JR), datë 11.10.2022, vendosi: *lënien në fuqi të vendimit nr. 259, datë 15.06.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.*
3. Kërkuesja ka paraqitur në Kolegji tri kërkesa për rishikimin e vendimit të mësipërm të Kolegjit, duke parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë vijon.

Kërkesa e parë për rishikim

3.1 Kërkuesja ka dorëzuar në Kolegji kërkesën për rishikimin e vendimit të formës së prerë me datë 09.04.2024, e protokolluar në Kolegji me nr. {***} prot. Shkaku i kërkesës së parë për rishikimin e vendimit të formës së prerë është sanksionimi i zbatimit të masës së proporcionalitetit nga GjEDNj-ja në rastin “Sevdari kundër Shqipërisë” dhe pranimi e zbatimit të këtij sanksioni nga Kolegji në kuadrin e pranimi për rihapje dhe rishqyrtim të çështjes së zgjidhur me vendim të formës së prerë. Referuar këtij vendimi, kërkuesja sqaron se qartazi citohen dy situata që kërkojnë një analizë serioze, po aq edhe të kujdesshme, përpara se të aplikohen sanksione disiplinore të rënda, të tilla si shkarkimi nga detyra, duke cituar konkretisht: (i) “jo çdo rast i vogël mosrespektimi i regjimeve të deklaratave të pasurive”; (ii) “jo çdo mospërputhje e parëndësishme midis shpenzimeve dhe burimeve të ligjshme”.

3.2 Kërkuesja shpjegon se, me këtë vendim GjEDNj-ja ka theksuar se vendosja e një mase të tillë, e cila ndikon negativisht në jetën private të një individi, kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit. Kërkuesja sqaron se parimi i proporcionalitetit është zbatuar referuar disa praktikave të përparshme të mbajtura nga Kolegji, por ka rezultuar se vendimmarrja përfundimtare ndaj saj si subjekt rivlerësimi nuk është marrë në zbatim të këtij parimi, pasi në asnjë rresht të vendimit

të Kolegjit nuk ka trajtim të këtij parimi. Nga ana tjetër, masa e shkarkimit nga detyra është vendosur pa analizuar nëse ekzistojnë prova të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit, kusht ky që citohet nga GjEDNj-ja. Kërkuesja sqaron se duke u marrë vendimi për çështjen e saj në Kolegj vetëm mbi kriterin e pasurisë, Kolegji nuk ka pasur asnjë mundësi për analizë të provave të forta në lidhje me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit, duke legjitimuar shkarkimin e saj mbi bazën e një pasaktësie dhe mospërputhjeje në një vlerë të pakonsiderueshme sipas logjikës që ndjek GjEDNj-ja në aspektin e vlerësimit të kriterit të pasurisë. Kërkuesja sqaron se diferenca negative e nxjerrë nga Kolegji për çështjen e saj të rivlerësimit sa i përket kriterit të pasurisë, është - 1.753.799 lekë.

3.3 Në përfundim të kësaj kërkese, znj. Bernina Kondi kërkon rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 37/2022(JR), datë 11.10.2022.

Bashkëngjitur kërkesës për rishikimin të vendimit gjyqësor të formës së prerë, kërkuesja ka bashkëngjitur si në vijim:

- (i) Vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 37/2022 (JR), datë 11.10.2022.
- (ii) Vendimin datë 11.03.2024 të Kolegjit, për pranimin e kërkesës për rishikim të znj. A. S..
- (iii) Njoftimin e pyetjeve drejtuar shtetit shqiptar në rastin “Thanza kundër Shqipërisë” nga ana e GjEDNj-së, publikuar në faqen zyrtare të kësaj gjykate (material në gjuhën angleze).

Kërkesa e dytë për rishikim

3.4 Më datë 27.05.2024, kërkuesja ka dorëzuar në Kolegj një kërkesë tjetër për rishikimin e vendimit të formës së prerë, e cila është protokolluar me nr. 449/7, dhe sipas nenit 19, pika 1/1 e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, i është bashkuar kërkesës së parë (datë 09.04.2024) për rishikim të paraqitur në Kolegj nga kërkuesja Bernina Kondi. Edhe nëpërmjet kësaj kërkese, është kërkuar rishikimi i vendimit të Kolegjit nr. 37, datë 11.10.2022, duke dhënë të njëjtat argumente si në kërkesën e parë për rishikim. Kërkuesja shpjegon se shkak i kërkesës është vendimi i marrë nga Kolegji në datën 10.05.2024, për çështjen që i përket znj. A. S., për rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 6/2019 (JR), datë 28.02.2019.

3.5 Për sa më lart, kërkuesja pretendon se plotësohen kërkesat e nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur zbulohen rrethana të reja apo prova të reja, me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj.

3.6 Kërkuesja kërkoj nga Kolegji pranimin e kërkesës për rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 37 (JR), datë 11.10.2022. Prishjen e vendimit nr. 37 (JR), datë 11.10.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe vazhdimin e gjykimit në themel.

Bashkëngjitur kërkesës ka paraqitur aktet si në vijim:

- (i) Vendimi nr. 37 (JR), datë 11.10.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit;

- (ii) Vendimi nr. 20, datë 10.05.2024, i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për pranimin e kërkesës për rishikim të znj. A. S.;
- (iii) Printim linku nga faqja e internetit të portalit Shqiptarja.com (i noterizuar);
- (iv) Printim linku nga faqja e internetit të portalit Shekulli.com (i noterizuar);
- (v) Vendime të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për subjektet B. M., A. K. (G.), E. Sh., A. M., M. O., E. Xh., P. Ç., H. K., E. T., G. Xh., A. K., mendim i pakicës për A. S.;
- (vi) Material i printuar “Strategjia e reformës në drejtësi”.

Kërkesa e tretë për rishikim

3.7 Më datë 18.04.2025, kërkuësja ka dorëzuar një kërkesë tjetër në Kolegji, e cila është protokolluar me nr. 555, dhe sipas nenit 19, pika 1/1 e rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit” i është bashkuar kërkesës së parë (datë 09.04.2024) për rishikim të paraqitur në Kolegji nga kërkuësja Bernina Kondi. Nëpërmjet kësaj kërkesë, ka kërkuar rishikimin e vendimit të Kolegjit nr. 37, datë 11.10.2022. Kërkuësja shpjegon se këtë kërkesë e ka paraqitur pasi është njohur, në mars të vitit 2025, me vendimin e arsyetuar nr. 20 (JR), datë 10.05.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit. Edhe në këtë kërkesë për rishikim, znj. Bernina Kondi ka paraqitur të njëjtat argumente si në dy kërkesat më sipër, lidhur me rishikimin e vendimit të formës së prerë.

- 4. Në seancën gjyqësore të datës 24.03.2026, trupi gjykues, bazuar në nenin 4, pika 6, të ligjit nr. 84/2016, nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, nenin 448 të Kodit të Procedurës Civile, dhe nenin 19, pika 1/1 të rregullores “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, vendosi të bashkojë për gjykim me çështjen nr. 9-32/2020 (JR), datë 09.04.2024 edhe kërkesat me nr. 449/7 prot., datë 27.05.2024 dhe me nr. 555 prot., datë 18.04.2025, të kërkuësës Bernina Kondi, me objekt rishikimin e vendimit nr. 37 (JR), datë 11.10.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

I. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Procesi gjyqësor në Kolegji

Juridiksioni i Kolegjit

- 5. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Gjithashtu, sipas pikës 3, të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion të shqyrtojë: a) shkeljet disiplinore të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.

6. Në vijim të sa më sipër, rezulton se i gjithë kuadri kushtetues dhe ligjor që rregullon procesin e rivlerësimit, nuk ka asnjë parashikim të shprehur literal, *së pari*, për të drejtën procedurale të paraqitjes së kërkesës për rishikim të subjekteve të rivlerësimit, brenda kuadrit të zhvillimit të këtij procesi dhe, *së dyti*, as për ndonjë kompetencë të Kolegjit që ushtrohet tej funksionit kontrollues të vendimeve të Komisionit në kuadër të juridiksionit të rivlerësimit, mbi bazën e ankimeve të paraqitura nga subjektet dhe Komisioneri Publik.
7. Duke konfirmuar të njëjtën linjë arsyetimi sikurse në vendimin e tij të mëparshëm, me nr. 12, datë 19.04.2024, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuarit A. Y., trupi gjykues i Kolegjit rithekson edhe në këtë rast në mënyrë të përmbledhur atë qëndrim, për sa i përket interpretimit të dispozitave të Kushtetutës, të nenit F të Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016 kundrejt juridiksionit rishikues të vendimeve të formës së prerë në procesin e rivlerësimit kalimtar. Konkretisht, nga leximi harmonik i këtyre rregullimeve, trupi gjykues vëren se në to parashikohet në mënyrë të shprehur vetëm juridiksioni rivlerësues i Kolegjit, në funksion të kontrollit ndaj vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në ankimet e subjekteve të rivlerësimit apo ato të ushtruara nga Komisionerët Publikë. Trupi gjykues ka theksuar se nga analiza e kuadrit rregullator të posaçëm, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit, sipas kërkesës së parashikuar prej kërkuarës, në çështjen objekt shqyrtimi. Mungesa e një parashikimi të tillë në ligjin e posaçëm, e shoqëruar edhe me mungesën e rregullave për trajtimin e kërkesave të tilla, diktoi nevojën e analizimit nga trupi gjykues i çështjes së cituar më sipër, të dispozitave që thirren për zbatim nga ligji nr. 84/2016.
8. Trupi gjykues i Kolegjit, në vendimin e referuar më sipër, ka arritur në konkluzionin se Kolegji i Posaçëm i Apelit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij, dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. Sikurse analizuar në detaj në vendimin e sipërcituar të Kolegjit, është analizuar përse procesi i rivlerësimit, duke qenë *sui generis*, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, i bën të pabazuara kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuarja.
9. Nga leximi harmonik i dispozitës së nenit F, pika 8¹ e Aneksit të Kushtetutës dhe germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile², një vendim i GjEDNj-së që konstaton një shkelje të kryer në çështjen e një ankuesi konkret, konsiderohet si i vetmi mjet procedural që kanë në dispozicion subjektet e rivlerësimit, në rast se të drejtat e tyre shkelen nga Kolegji në gjykimin e çështjeve të tyre dhe si e vetmja mundësi për të korrigjuar çdo gabim gjyqësor që mund të jetë konstatuar. Ky parashikim drejton subjektet drejt GjEDNj-së, duke konfirmuar natyrën e jashtëzakonshme të procesit, përjashtimin nga rregullat e zakonshme procedurale dhe orientimin për adresimin në këtë gjykatë, të çdo problematike që është konstatuar përgjatë

¹Subjektet që rivlerësohen mund të ushtrojnë ankim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

²“[...] Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë kur: [ë] Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane, “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore” dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.”

procesit e që ka çuar edhe në ndonjë gabim gjyqësor. Si rrjedhojë, subjektet e rivlerësimit kanë të drejtë të ankimojnë vendimet e Kolegjit në GjEDNj, për çdo rast që ata konsiderojnë se vendimmarrja ndaj çështjes së tyre të rivlerësimit, është në shkelje të parashikimeve të Konventës dhe Protokolleve të saj, të mbrojtura në Kushtetutë. Sipas këtij parashikimi, për trajtimin e të drejtave themelore të njeriut, GjEDNj-ja në sistemin tonë juridik ka një kompetencë ekskluzive.

10. Konkretisht, rrethanat që ligji parashikon se përbëjnë bazë për rishikimin e vendimeve, vlerësohet se nuk gjejnë zbatim në kontekstin e procesit të rivlerësimit të kërkuases. Në kushtet që procesi i rivlerësimit është i jashtëzakonshëm, zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës, nga organe me mandat të kufizuar kohor, për shkak të objektivitetit dhe natyrës së tij *sui generis*, që rezulton edhe nga mënyra sesi është rregulluar në ligj, Kolegji do të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit përkatës, sipas germës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile lexuar në harmoni me pikën 8, të nenit F të Aneksit të Kushtetutës.
11. Sa më sipër, për sa kuadri kushtetues dhe ligjor i rivlerësimit, si dhe institucionet që e kryejnë atë, japin garanci maksimale për të shmangur shkaqet e parashikuara në gjashtë germat e para të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile, vlerësohet se, jo pa qëllim, kushtetutbërësi ka parashikuar ankimin ndaj vendimeve të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në GjEDNj. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga leximi harmonik i nenit 179/b të Kushtetutës, nenit F të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, Kolegji do të kishte juridiksion rishikues vetëm mbi bazë të një vendimi të GjEDNj-së që potencialisht do të konstatonte se ekzistojnë shkaqet që përligjin shqyrtimin e një vendimi të formës së prerë të tij, nëpërmjet rihapjes së procesit, për të rivendosur të drejtën e cenuar.
12. Në analizë të sa më sipër, i jepet përgjigje përfundimtare kërkesave të paraqitura prej kërkuases, Bernina Kondi, për të cilën GjEDNj-ja nuk ka marrë ende një vendim. Këto kërkesa nuk mund të shqyrtohen nga Kolegji, për shkak të mospasjes prej tij të juridiksionit rishikues, sipas referimeve që kërkuësja bën në nenin 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, sipas analizës së dispozitave Kushtetuese dhe ligjore, si dhe referuar jurisprudencës³ së Kolegjit, trupi gjyqësor vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të Vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuases, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së.
13. Në përfundim, kërkesat e paraqitura prej kërkuases Bernina Kondi nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, dhe as në juridiksion rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, e nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, këto kërkesa konsiderohen nga

³ Vendimi nr.12, datë 19.04.2024, i Kolegjit, që i përket kërkesave për rishikim të kërkuetit A. Y.; Vendimi nr. 9, datë 28.02.2025, i Kolegjit që i përket kërkesës për rishikim të kërkuetit A. B.; Vendimi nr. 10, datë 28.02.2025, i Kolegjit, që i përket kërkesës për rishikim të kërkuetit B. M..

trupit gjykues si të papranueshme. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t'u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.

14. Trupi gjykues vëren se, ndonëse shkaqet e rishikimit të paraqitura prej kërkueses nuk i nënshtrohen juridiksionit rishikues të Kolegjit sipas arsytimit të mësipërm, të vlerësuara *obiter dictum*, konstatoi se rrethanat dhe provat e reja të pretenduara prej saj, nuk plotësojnë kërkesat e nenit 494, germa “a”, të Kodit të Procedurës Civile, për arsyet si vijojnë.

(a) Vendimet e Kolegjit, datë 11.03.2024, dhe nr. 20, datë 10.05.2024, janë marrë në kuadër të rigjyqimit në themel të çështjes gjyqësore të juridiksionit të rivlerësimit, (JR) nr. 17, datë 13.09.2018, si pasojë e pranimin të kërkesës së znj. S. për rihapjen dhe rishikimin e vendimit të Kolegjit, për shkak të vendimit të GjEDNj-së në çështjen “*Sevdari kundër Shqipërisë*”. Trupi gjykues vlerësoi se vendimet e mësipërme nuk konsiderohen si rrethanë e re në kuptim të një shkakut rishikimi, pasi ato kanë ngjarë pas dhënies së vendimit të Kolegjit, për pasojë ato nuk mund të konsiderohen në kuadër të përcaktimeve të nenit 494, germa “a” e Kodit të Procedurës Civile.

Edhe në versionin që ato do të konsideroheshin si rrethanë e re, në kuptim të nenit 494, germa “a”, të Kodit të Procedurës Civile, trupi gjykues arsyeton si vijon:

(b) Proporcionaliteti është një parim themelor kushtetues, i cili ka për qëllim që masat ndaluese të jenë të përshtatshme dhe të nevojshme, në mënyrë që pasojat e shkaktuara të mos jenë në disproporcion me qëllimin që synohet të arrihet nëpërmjet këtyre masave. Ky parim thirret për zbatim nga gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave specifike të çështjes e cila është objekt shqyrtimi dhe qëllimit që synohet të arrihet, për rrjedhojë nuk mund të pretendohet një standardizim i tij.

(c) Në vendimin nr. 20, datë 10.05.2024, Kolegji ka theksuar se procesi i rivlerësimit kalimtar, me natyrë *sui generis*, rregullohet sipas nenit 179/b të Kushtetutës, Aneksit të saj, dhe ligjit nr. 84/2016, dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cilave përcaktojnë se ky proces mund të përfundojë vetëm nëpërmjet dy alternativave vendimmarrëse të institucioneve të rivlerësimit, konfirmimit në detyrë ose shkarkimit nga detyra të subjekteve që i nënshtrohen këtij procesi. Kolegji, në rigjykimin e ankimit, ka theksuar se analizimi i situatës faktike dhe asaj juridike mbi zbatimin e legjislacionit të brendshëm, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, nuk ishte i nevojshëm, për sa kohë vendimmarrja e Kolegjit objekt kontrolli në GjEDNj, u cëna pasi në rrethanat specifike të kërkueses, masa disiplinore “shkarkim nga detyra” u konsiderua si joproporcionale. Gjithashtu, në këtë vendim, Kolegji ka arsyetuar se, pasi analizoi situatën faktike të konstatuar gjatë gjyqimit në themel, lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. A. S., angazhimi i Shkollës së Magjistraturës në përgatitjen e një programi 1-vjeçar në korrigjimin e një mangësie të vetme, nuk do të ishte i nevojshëm dhe se vetë gjykimi i zhvilluar në Kolegji kishte shërbyer si një mundësi e përshtatshme për vetëkorrigjimin e kësaj problematike nga subjekti i rivlerësimit. Në

përfundim, Kolegji ka konkluduar se: *për sa kohë lidhur me çështjen objekt gjykimi, dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, është çmuar nga GjEDNj-ja se ka cenuar nenin 8 të Konventës, e vetmja alternativë për përfundimin e procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. A. S., e cila nuk do të binte ndesh me vendimin e GjEDNj-së lidhur me çështjen “Sevdari kundër Shqipërisë”, duke përmbushur detyrimin e shtetit shqiptar për zbatimin e këtij vendimi dhe korrigjimin e shkeljes së konstatuar nëpërmjet dhënies së një vendimi në përputhje me parashikimet e nenit 8 të Konventës, do të ishte konfirmimi i subjektit të rivlerësimit në detyrë.*

Bazuar në sa më sipër, në vendimin e mësipërm, Kolegji nuk ka rivlerësuar situatën faktike dhe ligjore të kërkueses znj. A. S., nuk ka pasur asnjë analizë, nëse mungesa e burimeve financiare të ligjshme për kriterin e pasurisë ishte e tillë, që në zbatim të parimit të proporcionalitetit, ndaj saj nuk mund të merrej masa “shkarkim nga detyra”, por ka zbatuar drejtpërdrejt vendimin e GjEDNj-së, i cili ka konsideruar si joproporcional “shkarkimin nga detyra”, duke e konfirmuar atë në detyrë, si e vetmja alternativë që mbetet për vendimmarrjen, sipas legjislacionit të sipërcituar.

(d) Nga ana tjetër, në paragrafin 143 të vendimit të GjEDNj-së është arsyetuar se: *[...] Gjykata shprehet se ka konstatuar një shkelje të së drejtës së kërkueses për të respektuar jetën e saj private, sipas nenit 8 të Konventës për shkarkimin e saj, sepse, në rrethanat specifike të çështjes së saj, shkarkimi nuk ishte proporcional me qëllimet legjitime të ndjekura. Megjithatë, ajo nuk mendon se funksionimi i procesit aktual të rivlerësimit në përgjithësi në Shqipëri, mbështetur në Kushtetutë dhe në Ligjin e Rivlerësimit, paraqet problematika sistematike në respektimin e kërkesave të Konventës (shih tashmë Xhoxhaj, cituar më sipër, §§ 230 e në vijim). Për këtë arsye, Gjykata nuk e vlerëson si të nevojshme që ajo të përcaktojë në mënyrë përjashtimore ndonjë masë të përgjithshme që mund të ndërmerret për t'i dhënë fund shkeljes në fjalë (krahaso, a contrario, Oleksandr Volkov, cituar më sipër, §§ 199 – 202). Mbështetur në sa më sipër, GjEDNj-ja në vendimin e saj “Sevdari kundër Shqipërisë”, ka kërkuar vetëm rihapjen e procesit si një masë individuale për të korrigjuar shkeljen e nenit 8 të Konventës në vlerësim të rrethanave specifike të kërkueses, por nuk ka konstatuar problematika për funksionimin aktual të procesit të rivlerësimit, e për rrjedhojë, nuk ka urdhëruar masa të përgjithshme për t'i dhënë fund ndonjë shkeljeje lidhur me mënyrën e zbatimit të parimit të proporcionalitetit nga institucionet e rivlerësimit.*

(e) Trupi gjykues, në vendimin nr. 37 (JR), datë 11.10.2022⁴, nuk ka kryer një vlerësim bazuar në parimin e proporcionalitetit, pasi në vlerësimin tërësor të rrethanave, fakteve dhe konkluzioneve specifike në kriterin e pasurisë, ky parim nuk thirret për zbatim në çështjen objekt shqyrtimi.

(f) Bazuar në sa më sipër, pretendimet e kërkueses, se vendimet datë 11.03.2024 dhe nr. 20, datë 10.05.2024 të Kolegjit kanë përcaktuar një standard të ri për zbatimin e parimit të proporcionalitetit, u vlerësuan si të pabazuara nga trupi gjykues, e për rrjedhojë nuk u

⁴ Në vendimin e përmbledhur të datës 24.03.2026, paragrafi 9 (e), është referuar “vendimi nr. 20, datë 10.05.2024”, i cili përbën gabim në shkrim, pasi vendimi i saktë është “nr. 37 (JR), datë 11.10.2022”, që është korrigjuar në këtë vendim.

konsideruan sipas nenit 494, germa “a”, si rrethana të reja fakti me efekt në vendimin objekt i kërkesave të rishikimit.

15. Për sa më lart, trupi gjykues arriti në përfundimin se kërkesat e paraqitura prej kërkueses Bernina Kondi, nuk bëjnë pjesë në juridiksionin e rivlerësimit kalimtar të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas përcaktimit të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe as në juridiksionin rishikues të Kolegjit, sipas përcaktimit të nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile, për pasojë, ato konsiderohen të papranueshme.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 498, pika 1 e Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Mospranimin e kërkesave të kërkueses Bernina Kondi, për rishikimin e vendimit (JR) nr. 37, datë 11.10.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, të regjistruara me nr. 9-32/2020 (JR), datë 09.04.2024, me nr. 449/7 prot., datë 27.05.2024 dhe me nr. 555 prot., datë 18.04.2025.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 24.03.2026.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Albana Shtylla, jam dakord me zgjidhjen e çështjes për vendimin nr. 64 datë 24.03.2026, për çështjen nr. 9-32/2020 regjistër (JR) datë 09.04.2024, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës së kërkuases Bernina Kondi, për rishikimin e vendimit nr. 37 (JR), datë 11.10.2022, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, por kam mendim paralel, lidhur me arsyetimin e shumicës së trupit gjykues, për sa parashtruar në vijim.
2. Trupi gjykues në përfundim ka konkluduar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të vetë kërkuetit, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” e Kodit të Procedurës Civile dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së. Situatat e tjera të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm, për t’u zbatuar si rrethana për rishikimin e vendimeve civile/administrative të marra në përfundim të një procesi kontradiktor, u vlerësuan se nuk gjejnë zbatim brenda kontekstit të procesit të rivlerësimit, i cili është një proces i jashtëzakonshëm i realizuar prej organeve me mandat të kufizuar dhe që zhvillohet brenda një kuadri ligjor që përfshin edhe kufizimet e parashikuara nga neni A i Aneksit të Kushtetutës.
3. Në ndryshim nga shumica, në analizë harmonike të dispozitave kushtetuese, ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji “nr. 84/2016”) dhe legjislacionit në fuqi, kam vlerësuar se Kolegji i Posaçëm i Apelimit ka juridiksion rishikues për të shqyrtuar kërkesat për rishikim bazuar në të gjitha rrethanat e parashikuara të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile. Ky qëndrim bazohet në argumentet e referuara prej meje në mendimin paralel për kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuesi A.Y.⁵
4. Sa i përket shkaqeve të rishikimit të paraqitura në kërkesën e znj. Bernina Kondi, kam ndarë të njëjtin qëndrim si edhe pjesa tjetër e trupit gjykues, të pasqyruar në paragrafin 9 të vendimit, duke i konsideruar ato të pabazuara mbi të njëjtat argumente, duke vendosur mospranimin e tyre.

GJYQTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

⁵ Shiko mendimin paralel në vendimin nr.12, datë 19.04.2024 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit
https://kpa.al/wp-content/uploads/2024/11/Vendim-JR-A.-Y._perفشire-mendimet-paralele_anonimizar_word-1.pdf

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Natasha Mulaj, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, jam dakord me vendimin nr. 64 (JR), datë 24.03.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për: *“Mospranimin e kërkesave të kërkuases Bernina Kondi, për rishikimin e vendimit nr. 37/2022 (JR), datë 11.10.2022 të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, si dhe me arsyetimin se nga interpretimi i dispozitave të Kushtetutës, Aneksit të saj dhe ligjit nr. 84/2016, nuk rezulton të ketë asnjë parashikim të shprehur për ushtrimin e juridiksionit rishikues të Kolegjit. Procesi i rivlerësimit, duke qenë sui generis, me mandat në kohë të kufizuar dhe rregulluar me një kuadër kushtetues e ligjor të posaçëm, i bën të pabazuara kërkesat për rishikim të paraqitura nga kërkuësja.*
2. Në cilësinë e gjyqtares me mendim paralel, ndaj qëndrim ndryshe nga shumica trupit gjykues, e cila arsyeton se: *“[...] Kolegji i Posaçëm i Apelimit nuk ka juridiksion rishikues si një prej tagrave të tij dhe nuk është ngritur për t'i dhënë jetë këtij instituti sipas rregullimeve të përgjithshme të tij, parashikuar në nenet 494 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, me përjashtim të rasteve, në të cilat gjen zbatim germa “ë” e nenit 494, për shkak të një vendimi të shprehur të GjEDNj-së në trajtimin e një ankimi. [...], trupi gjykues vlerësoi se Kolegji i Posaçëm i Apelimit mund të ketë juridiksion rishikues vetëm nëpërmjet zbatimit të vendimeve të GjEDNj-së në përgjigje të ankimit të vetë kërkuases, në përputhje me parashikimet e nenit F, pika 8 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 494, germa “ë” të Kodit të Procedurës Civile, dhe detyrimeve që shteti shqiptar ka marrë përsipër në kuadër të zbatimit të KEDNj-së”.*
3. Në vlerësimin tim, si gjyqtare me mendim paralel, ky arsyetim nuk qëndron, pasi vjen si pasojë e një interpretimi të pabarabartë të situatave juridike të parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile, duke i atribuar Kolegjit mundësinë e rishikimit vetëm për rastin e parashikuar nga shkronja “ë” e kësaj dispozite: *“Kur Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut gjen shkelje të Konventës Evropiane ‘Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore’ dhe të Protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.*
4. Në mungesë të një parashikimi kushtetues dhe ligjor që t'i atribuojë Kolegjit juridiksion rishikues, kërkesat e rishikimit ndaj vendimit të saj nuk mund të pranohen. Në këto kushte, në vlerësimin tim, mbetet detyrë e ligjvënësit, për të rregulluar këtë situatë të krijuar, duke plotësuar kuadrin ligjor aktual, me qëllim përcaktimin e gjykatës kompetente dhe procedurat ligjore respektive për kryerjen e rishikimit të vendimeve të Kolegjit, të kërkuara nga subjektet e rivlerësimit.

GJYQTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Mimoza Tasi, në cilësinë e anëtares, jam dakord me zgjidhjen e çështjes në vendimin nr. 64, datë 24.3.2026, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuases Bernina Kondi për rishikimin e vendimit gjyqësor nr. 37 (JR), datë 11.10.2022, të Kolegjit, me të cilin është vendosur mospranimi i kërkesës, por kam ndarë mendim paralel sa i përket qëndrimin të mbajtur lidhur me arsyetimin për mungesën e juridiksionit rishikues⁶ të Kolegjit për shqyrtimin e kërkesave që nuk kanë një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas shkronjës “ë” të nenit 494 të Kodit të Procedurës Civile.
2. Në vlerësimin tim, Kolegji ka juridiksion rishikues për shqyrtimin e kërkesave për rishikim vendimi që janë paraqitur bazuar në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile. Argumentet e mia kundërshtuese për mungesën e juridiksionit rishikues dhe qëndrimin e mbajtur janë shprehur në mënyrë shteruese dhe konsistente në kërkesat për rishikim të shqyrtuara në Kolegji⁷.
3. Një interpretim nga Kolegji që pranon rishikimin vetëm pas vendimit të GjEDNj-së, në përgjigje të ankimit të kërkuarit (subjekt rivlerësimi), e bën juridiksionin rishikues të varur vetëm nga gjykata e Strasburgut, duke hequr mundësinë e çdo mekanizmi korrigjues të brendshëm dhe duke krijuar një vakum juridik për shkelje serioze që nuk kanë arritur ende në GjEDNj.
4. Pranimi i juridiksionit rishikues vetëm në mënyrë minimaliste dhe vetëm për vendimet e GjEDNj-së, në vlerësimin që i bëj çështjes, duket se krijon një kontradiktë logjike, sepse e bën rishikimin një “mjet të jashtëm” dhe jo “mjet të brendshëm”, duke lënë pa zgjidhje gabimet serioze të brendshme që përbëjnë shkaqet e rishikimit sipas shkronjave të tjera të nenit 494 të Kodit. Pra, nëse rishikimi do të ekzistojë vetëm pasi GjEDNj-ja të shprehet me një vendim të posaçëm për kërkuarin (subjekt rivlerësimi), kjo do të passillte që mjete të brendshme të mos jetë efektiv⁸ dhe kjo mund të çojë në shkelje të nenit 13⁹ të KEDNj-së.
5. Në lidhje me kërkesën e kërkuases Bernina Kondi, paraqitur më 09.04.2023, të cilën ka e bazuar në nenin 494/a të Kodit të Procedurës Civile, ndaj qëndrim të njëjtë me trupin gjykues.

GJYQTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

⁶ Ky qëndrim është mbajtur nga shumica e trupës gjyqësore në vendimin nr. 12, datë 19.4.2024, që ka shqyrtuar kërkesën e kërkuarit A. Y., regjistruar me nr. 2-4/2019 regjistër (JR), datë 10.1.2022, me objekt “Rishikimi i vendimit të formës së prerë nr. 31 (JR) të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit”, në të cilin nuk kam qenë anëtare e trupit gjykues.

⁷ Vendimi i Kolegjit nr. 34, datë 06.12.2023, që i përket kërkuases R. G.; vendimi i Kolegjit nr. 9, datë 28.2.2025, që i përket shqyrtimit të kërkesës së kërkuarit A. B., Vendimi i Kolegjit nr. 18, datë 8.5.2025, që i përket shqyrtimit të kërkesave të kërkuarit A. Gj., etj.

⁸ Çështja “Scordino v. Italy (No. 1) (GC, 2006) (Application no. [36813/97](https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925)) - <https://hudoc.echr.coe.int/eng?i=001-72925>”.

⁹Neni 13 i KEDNj-së: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”